Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/233
Datë: 07.06.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit nr. 28/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2021 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. **Aprovohen** Standardet e Profesioneve së bashku me të gjitha rekomandimet e paneleve të ekspertëve si standarde kombëtare të profesionit me kohëzgjatje 5 vjeçare, me këto emra dhe kode:

1. Këpucëtarët dhe punëtoret e ngjashëm, me kodin 7536 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK;
2. Zyrtar Policorë, me kodin 5412 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK;
3. Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës, me kodin 3355 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK;
4. Zyrtar Korrektues, me kodin 5413 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK;
5. Zyrtar Sprovues, me kodin 2635 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK;
6. Zyrtar Doganor, me kodin 3351 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Bazuar në kërkesën e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (KAAPRr/MASHT) për verifikimin e standardit të profesionit, KD i AKK, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2021, ka shqyrtuar raportet e ekspertëve për standardet e profesioneve. Duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve në proces të verifikimit të Standardeve të Profesionit gjatë realizimit të takimeve dhe vizitave me palët e interesit, si dhe